

VENDIM
Nr.1428, datë 22.10.2008

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT,
DATE 18.12.2007 PËR ÇËSHTJEN “MARINI KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë, të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 18.12.2007, për çështjen nr.3738/02 “Marini kundër Shqipërisë”, në shumën 335 700 (treqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind) euro.

2.Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 29 tetor 2008.

3.Shuma 335 700 (treqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind) euro të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit “Marini kundër Shqipërisë” dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

4.Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, ndaj ankuesit, shtetasit Vlash Marini, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes të të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm, për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

5.Kundërvlefte në lekë e shumës së parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6.Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha